# DËSHMI ARKIVI

**A-462373**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Gazetarja zbulon detaje nga dosja e Hysenit: Dyshohet për komunikime me Agasin kur ishte në kërkim \| |
| ADRESA | `https://boldnews.al/2026/09/22/gazetarja-zbulon-detaje-nga-dosja-e-hysenit-dyshohet-per-komunikime-me-agasin-kur-ishte-ne-kerkim/` |
| BURIMI | boldnews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:45:27 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 22 shtator 2026, 20:05:33 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `4d2f26588d98b58c21b66119714918a7e20165c6b65482b08abda8b56aaf333d` |
| TEKSTI | `702a8f617787648b6c030f91da28697150d0009bd5f42ed67295d2fa1bbb8aa7` |
| PAMJA | `e01c74a7a904853389b746022a366328628dd53b244d122fa6ed115376e60424` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `233923b147f2a835f8a79f448c88ecd9b588b281046b76ac3c95f8fe678c1359` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/233923b147f2a835f8a79f448c88ecd9b588b281046b76ac3c95f8fe678c1359`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Gazetarja zbulon detaje nga dosja e Hysenit: Dyshohet për komunikime me Agasin kur ishte në kërkim

22:05 : 22/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE




Gazetarja Anila Hoxha ka dhënë detaje të reja lidhur me hetimin ndaj ish-drejtoreshës së SHISH, Vlora Hyseni, gjatë një interviste në emisionin "Top Story".

Hoxha u ndal te udhëtimi i Hysenit drejt Kosovës dhe mënyra se si ajo është dorëzuar te autoritetet, duke theksuar se vetëdeklarimi i saj pritet të hedhë dritë mbi lëvizjet e saj dhe rrethanat e kthimit.

Sipas gazetares, në kuadër të hetimeve janë ngritur dyshime edhe mbi komunikimet që Hyseni mund të ketë pasur me persona të tjerë të përfshirë në dosje. Ajo tha se pas arrestimit të Ergys Agasit dhe sekuestrimit të telefonit të tij, dyshohet se janë gjetur komunikime me Hysenin dhe Emrbo Sulejmanin gjatë periudhës kur Agasi ishte në kërkim.

Hoxha tha se ndaj Hysenit dyshohet për dy vepra penale, ndërsa hetimi mund të zgjerohet edhe ndaj personave të tjerë, në varësi të provave dixhitale dhe komunikimeve që mund të jenë administruar nga SPAK.

"Me administrimin e disa provave të tjera, prova dixhitale, ose bisedat në telefona në muajin gusht gjatë arrestimit të Ergys Agasit, gjasat do të jenë që të jenë persona të tjerë që do të jenë në vështirësi përpara gjykatës", u shpreh gazetarja.

**Lexo edhe:**

9 faqet e SHISH në makinën e Agasit, bashkëpunim apo nxjerrje informacioni? Ku nis përgjegjësia penale?

510 komunikime Hyseni-Agasi, Berisha: Pse ish-kreu i SHISH nuk u cilësua pjesë e grupit kriminal?

Një tjetër emër i përmendur prej saj është Emrbo Sulejmani. Sipas Hoxhës, ai dyshohet se ka ndihmuar Agasin gjatë kohës që ky i fundit ishte në kërkim, duke i siguruar ushqime dhe ndihma të tjera.

Gazetarja foli gjithashtu për dyshime që lidhen me shefin e laboratorit shkencor të Policisë, Fatjon Kalluçi. Sipas saj, ekziston dyshimi se të dhëna sekrete të administruara gjatë një ekspertimi, të cilat pritej t'i kalonin SPAK-ut, mund t'i jenë përcjellë Agasit.

## TË GJITHA


9 faqet e SHISH në makinën e Agasit, bashkëpunim apo nxjerrje informacioni? Ku nis përgjegjësia penale?
20:42 : 23/09/2026


Arrestohet në Rusi Shpëtim Aliu, një nga "bossët" e rrjetit të trafikut ndërkombëtar të kokainës
20:32 : 23/09/2026


Administrata Trump po përgatit planin për ndalimin 90-ditor të eksporteve të naftës
20:17 : 23/09/2026


Stresi dhe inflamacioni mund të dëmtojnë zemrën në heshtje
20:17 : 23/09/2026


Berisha përjashton bojkotin e Parlamentit: Do ishte në favor të Ramës
20:04 : 23/09/2026


Dosja e SHISH, Salianji: Shteti ka rënë në duart e bandave
19:55 : 23/09/2026


Haxhiu i ftoi në takim, familjarët e 4 ish-krerëve të UÇK-së refuzojnë: Pasi Kuvendi të marrë vendim për Hagën
19:47 : 23/09/2026

Hoxha përmendi edhe një informacion që, sipas saj, është pjesë e materialeve të klasifikuara të hetimit dhe lidhet me vendin ku dyshohet se Agasi është fshehur gjatë kohës që ishte në kërkim. Ajo tha se për këtë çështje ekziston një vendim gjyqësor që ndalon publikimin e të dhënave.

Sipas gazetares, hetimi ndaj Hysenit është pjesë e një procedimi më të gjerë që lidhet me dosjen e AKSHI-t dhe hetimet e nisura gjatë vitit 2025.

Sa i përket ish-drejtorit të Policisë së Shtetit, Ervin Prodës, Hoxha tha se aktualisht nuk ka një status të përcaktuar në kuadër të kësaj dosjeje.

**Etiketa:** Gazetarja Anila Hoxha | shish | vlora hyseni

## Lajme të lidhura



**9 faqet e SHISH në makinën e Agasit, bashkëpunim apo nxjerrje informacioni? Ku nis përgjegjësia penale?**
20:42 : 23/09/2026




**510 komunikime Hyseni-Agasi, Berisha: Pse ish-kreu i SHISH nuk u cilësua pjesë e grupit kriminal?**
18:53 : 23/09/2026



**E përfshirë në dosjen e Ergys Agasit/ Ish drejtoresha e SHISH, Vlora Hyseni nesër para GJKKO**
16:48 : 23/09/2026



**Berisha: Rama e ka përdorur Vlora Hysenin për të rrëzuar qeverinë në Kosovë**
14:23 : 23/09/2026



**Mbi 500 telefonata e mesazhe mes Hysenit dhe Agasit/ Si ranë në duart e hetuesve përgjimet e forta**
14:15 : 23/09/2026



**"Po tentohet të paraqitet si aferë dashurie"/ Berisha: Rama ishte në dijeni të çdo vendimi të Vlora Hysenit**
14:06 : 23/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.
Na kontakto: [email protected]

NA NDIQ

2026 Boldnews Dev By Techzero1.com

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.